



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 21.21.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË**  
**INTEGRIMIT EVROPIAN**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Integrimit Evropian, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Fjolla Bakalli – Sadiku (*udhëheqës i ekipit*), si dhe Pleurat Isufi dhe Albana Kadriu-Zogjani (*anëtar të ekipit*) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Bujar Bajraktari.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	18
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	22

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Integrimit Evropian për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Auditimit, të datës 24/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar në varësi të cilësisë së kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Integrimit Evropian.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Ministrja është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Integritit Evropian (MIE). Ne kemi analizuar veprimtarinë e MIE-së për të vlerësuar se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe testimin e aranzhimeve të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Integritimit Evropian për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MIE-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga

---

mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Integritimit Evropian.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MIE kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve kemi identifikuar se:

- Te neni 14 – Raporti i ekzekutimit të buxhetit, kishte një mbivlerësim të buxhetit final për mallra dhe shërbime për shumën 13,792€, në krahasim me informatat në SIMFK, duke mbivlerësuar edhe buxhetin e përgjithshëm për këtë shumë. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së informatave për reduktimin e buxhetit me vendim të qeverisë në fundvit.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë pasi që gabimi i identifikuar nuk është i natyrës materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm nuk kemi çështje materiale për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Në lidhje me mbivlerësimin e cekur më lartë jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Ministria duhet të sigurojë se zyrtarët e financave i përcjellin në vazhdimësi veprimet e qeverisë në lidhje me ndryshimet buxhetore, dhe ato ndryshime të reflektohen edhe në PFV në mënyrë që të paraqiten informatat e sakta.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fusha e prokurimit kishte disa dobësi që mbeten të adresohen në të ardhmen. Më tutje, në MIE vazhdojnë të mbahen pozita me ushtrues detyre për periudha të gjata kohore duke i tejkaluar limitet e lejuara. Kjo dukuri duhet të evitohet dhe mbetet si fushë që kërkon përmirësim.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,679,904</b>	<b>1,435,649</b>	<b>1,337,782</b>	<b>1,511,752</b>	<b>1,617,905</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,679,904	1,435,649	1,337,782	1,511,752	1,617,905

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 244,255€. Ky zvogëlim i buxhetit ishte rezultat i kursimeve të aplikuara me procesin e rishikimit buxhetor dhe me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2017, MIE kishte shpenzuar 93% të buxhetit final ose 1,337,782€. Shpenzimi ishte në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,679,904</b>	<b>1,435,649</b>	<b>1,337,782</b>	<b>1,511,753</b>	<b>1,617,905</b>
Pagat dhe Mëditjet	643,242	613,242	584,749	582,852	669,779
Mallrat dhe Shërbimet	770,962	762,708	693,414	763,434	859,056
Shërbimet komunale	10,500	5,500	5,442	5,740	7,028
Subvencionet dhe Transferet	250,000	50,000	49,987	159,727	82,042
Investimet Kapitale	5,200	4,200	4,190	-	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me atë fillestar ishte zvogëluar për 30,000€. Ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit. Niveli i realizimit të buxhetit final ishte 95%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 8,254€, si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë. Niveli i realizimit të buxhetit final ishte 90%;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 5,000€, në krahasim me buxhetin fillestar si rezultat i rishikimit të buxhetit. Niveli i realizimit të buxhetit final ishte 98%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 200,000€ në raport me buxhetin fillestar me proces të rishikimit buxhetor ku mjetet në vlerë prej 20,000€ ishin transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa pjesa tjetër ishte deklaruar si kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 100%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillesar ishte zvogëluar për 1,000€ me rishikim të buxhetit. Buxheti final ishte realizuar 99%.

---

## 3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MIE-së, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 613,242€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 584,749€. Numri i planifikuar i stafit ishte 86 ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2017 ishte 84. Testimet tona nuk kanë vënë në pah ndonjë mangësi në këtë fushë.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.3 Menaxhimi i personelit

Në vijim janë paraqitur disa nga çështjet e identifikuara që kanë të bëjnë me dobësitë në menaxhimin dhe organizimin e personelit.

---

### Çështja 2 - Mbajtja e pozitave të punës me Ushtrues Detyre

**E gjetura** Rregullorja nr. 06/2012 për emërimet në shërbimin civil përcakton se asnjë pozitë e lartë drejtuese nuk mund të mbahet me ushtrues detyre me tepër se tre muaj. Ne kemi vërejtur se në MIE tri pozita udhëheqëse mbahen me Ushtrues Detyre, duke tejkaluar limitin e lejuar për mbajtjen e pozitës në formë të tillë. Një nga këto pozita mbahet me UD që nga viti 2015, derisa dy të tjerat nga maji i vitit 2017, për shkak se zyrtarët që i kanë mbajtur këto dy pozita, ishin në pushim pa pagesë, me qëllim të avancimit profesional.

**Rreziku** Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre në periudha të gjata, është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe mund të ndikoj në cilësinë e performancës operacionale të entitetit.

**Rekomandimi 2** Ministrja duhet të siguroj që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2017 ishte 768,208€. Prej tyre ishin shpenzuar 698,856€. Ato kanë të bëjnë me furnizime për zyrë, furnizim me mobilje, furnizime me karburant për vetura, shpenzime të udhëtimit zyrtar, dreka zyrtare, pagesa të qirasë, etj. Testimet tona kanë evidentuar çështjen në vijim:

#### Çështja 3 – Nënshkrimi i kontratës jo në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit

- E gjetura** Kontrata e nënshkruar për “Furnizim me inventar për nevojat e MIE-së”, në vlerë prej 7,025€, sipas kërkesës së dosjes së tenderit parashihte furnizimin me 14 artikuj. Të gjitha procedurat si dhe vlerësimi i ofertave financiare është bërë përkitazi me këto kërkesa. Mirëpo kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik fitues, kishte specifikuar se Ministria do të furnizohet vetëm me gjashtë artikujt nga lista e artikujve të ofertuar. Kjo është në kundërshtim me kërkesat të cilat janë paraqitur nga entiteti në dosjen e tenderit si dhe me kërkesat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik A01 (*Neni 47.40*). Për më tepër, po të ishte bërë kërkesa vetëm për artikujt të cilët janë kontraktuar, oferta e OE fitues rezulton të jetë për 320€ më e lartë sesa oferta e dytë.
- Rreziku** Mos-përfillja e kërkesave të dosjes së tenderit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe mund të rezultoj me përzgjedhje jo të drejtë, shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të tenderuesve dhe vlerë të dobët për para në praktikën e prokurimit.
- Rekomandimi 3** Ministria, duhet të sigurojë se me rastin e shpalljes së njoftimeve për furnizim, të bëhen analiza më të detajuara të kërkesave të paraqitura nga njësitë kërkuese dhe të aprovohen vetëm kërkesat e arsyetuara. Gjithashtu kontratat duhet të nënshkruhen sipas kërkesave të parapara në dosjen e tenderit.

### 3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 50,000€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 49,988€. Ato kanë të bëjnë me subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të personave fizik dhe organizatave jo-qeveritare, të cilët kanë për qëllim promovimin e procesit të integritetit evropian të Republikës së Kosovës. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë mangësi në këtë fushë.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,200€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 4,190€. Këto shpenzime kishin të bëjnë me blerjen e një kamere digjitale që ishte i vetmi shpenzim kapital i planifikuar. Ne e kemi testuar procesin e kësaj blerje dhe nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi të procesit.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

MIE kishte prezantuar në PFV pasuri kapitale (mbi 1,000€) në vlerën neto prej 8,633€ dhe pasuri jo kapitale (nën 1,000€) në vlerën prej 62,465€. Ne kemi testuar blerjet e vitit dhe rregullsinë në evidentimin dhe inventarizimin e pasurisë në dispozicion. Nuk kemi evidentuar ndonjë mangësi.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 30,212€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Këto obligime kanë të bëjnë me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe shërbime komunale. Ne kemi testuar mënyrën e raportimit të obligimeve të papaguara, duke filluar nga protokollin, raportimi e deri te pagesa e obligimeve. Testimi ynë nuk ka evidentuar ndonjë mangësi.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e MIE-së, të vitit 2016 kishte rezultuar në gjashtë rekomandime. MIE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime ishin zbatuar, një ishte në proces dhe një nuk ishte adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe tri rekomandime (të pa zbatuara). Dy nga këto rekomandime në vitin 2017 janë zbatuar në tërësi ndërsa një rekomandim nuk ishte zbatuar.

### Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

<b>E gjetura</b>	Edhe përkundër progresit të arritur në zbatim të rekomandimeve, mbetet të punohet më shumë për adresimin e tyre në tërësi, në mënyrë që të evitohen çështje të përsëritura ndër vite.
<b>Rreziku</b>	Vonesat në zbatimin e rekomandimeve mund të rezultojë me dobësi të vazhdueshme, mungesë të efikasitetit dhe me humbje potenciale financiare.
<b>Rekomandimi 4</b>	Ministrja duhet të siguroj zbatim të plotë të planit të veprimit, duke përcaktuar saktë afatet kohore për zbatimin e plotë të rekomandimeve. Progresi në zbatimin e këtyre rekomandimeve duhet të raportohet te Ministrja dhe Sekretari i Përgjithshëm në baza të rregullta kohore.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MIE në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit.

Qeverisja në MIE në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. MIE kishte zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe kishte përgatitur regjistrin e rreziqeve i cili ishte azhurnuar në përputhje me kërkesat e MFK-së. Poashtu pyetësi i vetëvlerësimit ishte plotësuar dhe dorëzuar me kohë në Ministrinë e Financave si dhe reflektonte situatën reale të organizatës buxhetore. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. Mbetet ti kushtohet më shumë rëndësi planifikimit dhe realizimit efikas të planit të auditimeve të AB që përfitimi të jetë maksimal.

### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në MIE është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) e cila përbëhet nga një Auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB, kishte hartuar planin vjetor të punës i cili ishte i bazuar në planin strategjik dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut. Poashtu ishin kryer raportime të rregullta nga NjAB në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm. Raportet e auditimit përmbanin konkluzionet në lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet për korigjimin e gjendjes aty ku kishte të gjetura. Megjithatë plani vjetor nuk ishte realizuar plotësisht.

MIE ka formuar Komitetin e Auditimit në fund të muajit shtator të vitit 2017. Ky komitet kishte arritur ti mbante dy takime deri në fund të vitit, në të cilat ishin shqyrtuar rekomandimet e auditimit dhe niveli i adresimit të tyre.



---

## Çështja 5 – Mos-përmbushje e plotë e planit vjetor të auditimit

- E gjetura** NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar që të kryejë katër auditime dhe një auditim me kërkesë nga menaxhmenti. Nga ky plan kishte arritur që ti përfundoj tri, auditime të rregullta duke mos përmbushur planin. Derisa nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga menaxhmenti për ndonjë auditim.
- Rreziku** Mos përmbushja e planit të NjAB-së, mund të ndikojë në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive të mundshme në kontrolle dhe të humbet mundësia për përmirësime.
- Rekomandimi 5** Ministrja duhet të sigurojë se plani i punës i NjAB-së është përmbushur në tërësi dhe ndihmon aktivitetet operative në vazhdimësi. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj në mënyrë më kritike planet e NjAB-së, në mënyrë që menaxhimi kohor të jetë sa më efikas.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

MIE në përgjithësi kishte vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm që përfshin raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave. Linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin të qarta dhe funksionale përmes raporteve dhe takimeve të rregullta.

Procesi i menaxhimit të rrezikut në përgjithësi ishte në drejtim të mirë të zhvillimit në përputhje me kërkesat e MFK. MIE posedonte regjistrin e rreziqeve që ishte azhurnuar në fund të vitit 2017.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se për pozitën e udhëhequr me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.			Nuk është zbatuar. Vazhdon të ketë pozita me UD duke e tejkaluar afatin ligjor.
Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shtuar kontrollet, në të gjitha fazat e procesit të subvencionimit të projekteve.	Është zbatuar. Nuk kemi hasur raste të tilla këtë vit.		
Trajtimi i obligimeve	Ministri duhet të sigurojë se detyrimet ndaj furnitorëve paguhen me kohë. Nëse për ndonjë arsye borxhet mbasin të papaguara, ato duhet të raportohen në MF/Thesar.	Është zbatuar. Të gjitha faturat e mbetura të papaguara ishin raportuar në MF/Thesar.		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Ministri duhet të sigurojë që në vazhdimësi mbanë llogaridhënës personat përgjegjës të përcaktuar në planin e veprimit me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së, sipas afateve kohore të përcaktuara.		Në proces të zbatimit. edhe një rekomandim nga viti 2015 kishte mbetur pa zbatuar	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që është formuar në afat sa më të shkurtë Komiteti i Auditimit në bazë të kërkesës ligjore. Duke emëruar një komitet kompetent do t'i ngritej vlera e auditimit të brendshëm dhe do të sigurohej një funksion i mirëfilltë i zinxhirit të kontrolleve të brendshme.	Është zbatuar. Komiteti i auditimit ishte formuar në shtator të vitit 2017.		
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit . Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar me kërkesat ligjore.			Nuk është zbatuar. Vazhdon të ketë pozita me UD duke e tejkaluar afatin ligjor.
3.1.3 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për ta rishikuar rregulloren për menaxhimin e subvencioneve, për të siguruar se përfshinë pikat kyçe të cilat do ta lehtësonin procesin e monitorimit të tyre. Me pas me marrëveshjet individuale duhet të specifikohen detajet për secilin subvencion të dhënë.	Është zbatuar. Nuk kemi hasur raste të tilla këtë vit.		
	Ministri i MIE duhet të sigurojë se para nënshkrimit të marrëveshjeve të tilla, janë respektuar të gjitha procedurat e parapara me kornizën ligjore. Në këtë mënyrë do të sigurohej një bazë e mirë që MIE të zhvillojë aktivitetin e vet duke e ngritur edhe vlerën për para.	Nuk ishte identifikuar ndonjë rast i ngjajshëm këtë vit. MIE nuk kishte realizuar asnjë aktivitet të përbashkët me organizatat ndërkombëtare.		
3.3 Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmanget ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga Thesari. Nëse për ndonjë arsye obligimet mbesin të papaguara, aato duhet të raportohen në Thesar.	Është zbatuar. Të gjitha faturat e mbetura të papaguara ishin raportuar në MF/Thesar.		

## Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
20.06.2018			
03	147	1097	1
Titulli / Title	Kodi i Klasifikimit / Class. Code	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr.faqeve / No. Pages



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Integritimit Evropian / Ministarstvo Evropske Integracije Ministry of European Integration	
SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot. / Prot. No.	156-1-2018
Nr. i faqeve / Broj strana / No. pages	20, 06, 2018
PRISHTINE/A	

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Integritimit Evropian*  
*Ministrarsvo za Evropsku Integraciju/Ministry of European Integration*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

20 Qershor 2018, Prishtinë

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE), për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

*Dhurata Hoxha*  
Dhurata Hoxha  
Ministre e Integritimit Evropian

